Është një nga objektivat kryesore të SPASH për vitin 2006. Përvoja e vitit që kaloi dhe mendimet e shprehura gjatë gjithë fushatës elektorale zgjedhore nga strukturat bazës sindikaliste të SPASH dhe në Kongresin e IV të saj, tërheqin vëmëndjen se pa një organizatë sindikaliste solide, të zhvërvjellte, në gjëndje që tu përgjigjet situatave në çdo kohë dhe të marrë vendime të qarta e të zbatueshme në kohën e duhur e në përputhje me politikën, strategjinë e vendim-marrjen e forumeve të larta të SPASH dhe BSPSH, nuk mund të vihen detyra për zbatim dhe të ketë realizim të tyre. Pavarësisht nga situata ekzistuese organizative dhe puna për shëndoshjen e mëtejshme të saj, ristrukturimi i organizatave sindikaliste ekzistuese të SPASH dhe fuqizimi i tyre në vijimësi sipas situatave, si dhe krijimi e forcimi i organizatave sindikaliste në shkollat e arsimit parauniversitar shtetëror sidomos në arsimin e detyrueshëm atje ku SPASH nuk ka anëtarësi, me synim edhe në sistemin e arsimit privat, sidomos në Tiranë, Durrës, Kukës, Përmet, Skrapar etj, duhet të jetë një nga objektivat e punës për vitin 2006.

3. Statusi i Mësuesit, Kontratave Kolektive të Punës. Përvoja është...Nuk duhet pritët.

Synimi dhe këmbëngulja për të realizuar një nga synimet kryesore sindikaliste, është hartimi, diskutimi dhe këmbëngulja për miratimin e Statusit

SPASH-Realitete dhe objektiva për vitin 2006

Vijn nga faqja 9

të Mësuesit, si një nga prentimet qeveritare, krahas luftës për lidhjen në një kohë sa më të shkurtër të Kontratës Kolektive të punës së nivelit të Parë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës sipas prentimeve që ka bërë ministri Genci Pollo në takimet me SPASH dhe FSASH, synimi që të paktën të mos kalojë një muaj nga momenti i lidhjes së kësaj kontrate për të lidhur këto kontrata me Drejtoritë Arsimore në rrethe e Qarqe, në nivelin e dytë.

3. Kuotat sindikaliste

"Gangrena" e shlyerjes së detyrimeve staturore për derdhjen e kuotave sindikaliste, ka qënë dhe mbetet ende problem. Është bërë ves nga të gjithë që të shprehemi: "anëtarësi me kuota" dhe "anëtarësi pa kuota" (d.m.th. simpatizantë). Një ndarje e tillë, ka shkaktuar probleme deri aty sa të shkelen jo vetëm ligji por dhe Statuti i SPASH dhe i BSPSH-së. Nuk mund të ketë anëtarësi në sindikatë pa derdhur kuotën e kësaj anëtarësie. Sindikata mbajn anëtarësinë e deklaruar të saj dhe grupet shoqërore që përfaqëson

ligjërisht. Sindikata nuk është "Shoqëti Zogjsh". Sindikata është partnere sociale dhe vetëm asaj sipas ligjit, por dhe sipas konventave ndërkombëtare të ratifikuara edhe nga Qeveria Shqiptare i njihet mbrojtja e interesave ekonomike e sociale të punëtarëve në të gjitha institucionet shtetërore dhe shoqëritë tregtare private të çdo forme dhe tipi qofshin. Këtë duhet ta kuptojë çdo punëtarës. Dërdhja e kuotës së anëtarësisë, është detyrë staturore e cilitdo anëtar.

Çdo ditë dëgjojmë në mediat elektronike arkesa të tilla si: "Ç'është Sindikata", "A ka Sindikata" ? etj. etj. Po, sindikata ka dhe ato mbrojtje qoftë edhe ligjërisht vetëm anëtarësinë e tyre që paguan kuotën e anëtarësisë. Në drejtim të shlyerjes së detyrimeve staturore, sipas zotit Dërdhim Spahiu, deri tani dallohen SPA në Shkodër, Elbasan dhe Peshkopi. Po të tjerët? Kuptohet me mangësi..., kur dihet që baza financiare e një organizate sindikale është kuota.

4. Forcimi i marrëdhënieve institucionale dhe dialogu social

Është një nga objektivat e SPASH për vitin 2006. Dialogu social dhe bashkëpunimi institucional jo vetëm me homologen FSASH, por dhe me institucionet shtetërore dhe punëdhënësin shtetëror apo privat, është në themel të politikës dhe strategjisë së SPASH dhe BSPSH-së. Kur dialogu social për kërkesat sindikaliste nuk pirë ujë, atëherë kalohet në shkallëzimin e aksionit sindikalist për realizimin e kërkesave sindikaliste sipas ligjit. Bashkëpunimi ndërsindikalist në momentet kur dialogu social nuk zgjidh kërkesat zyrtare të shpallura ekonomike e sociale sindikaliste, fuqizimi nëpërmjet këtij bashkëpunimi për aksionin e përbashkët sindikalist përballë punëdhënësit marr rëndësi të veçantë. Në veçanti, forcimi i marrëdhënieve institucionale me Drejtoritë arsimore, për zgjidhjen e të gjitha problemeve nëpërmjet dialogut social është me rëndësi të veçantë. Këto marrëdhënie, bëjnë që të zgjidhen edhe njaft probleme korrente e të ditës dhe kërkesa sindikaliste që lindin në praktikën dhe dinamikën e punës.

Koha e teknologjise se informimit dhe komunikimit ne shkolla

Mundësitë dhe rreziqet

Një nga ndryshimet në themelore të përjetuara nga shoqëritë europiane gjatë njëzetë vjetëve të fundit ka qënë fitja e Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit, (TIK), në botën e punës dhe në shumë shtëpi. Jeta jonë, në vendin e punës dhe në shtëpi, ka ndryshuar në shumë mënyra. Disa nga këto ndryshime e kanë bërë jetën më të lehtë, ndërkohë që të tjera kanë nxjerrë shumë probleme dhe sfida.

Edhe shkollat janë ndikuar nga këto ndryshime. Disa njerëz mendojnë se shkollat janë ndikuar më pak se sektorë të tjerë të shoqërisë. Disa të tjerë

argumentojnë se TIK ka një potencial të stërnadh për të ndryshuar arsimimin, shkollimin dhe nësimdhënien.

Për mësuesit është me rëndësi të madhe reflektimi mbi ndryshimet që janë bërë tashtë në shkolla si edhe që mund të ndodhin së shpejti. Kjo ngre pyetje që lidhen me mënyrën se si ne do të dëshironim të përshtasim arsimimin, shkollimin dhe nësimdhënien në të ardhmen.

Në mënyrë që të sigurohen mundësitë dhe burimet e duhura për të shqyrtuar intësisht këto çështje, Komiteti Europian i Sindikatave të

Arsimit, ETUCE, është angazhuar në një projekt mbi përdorimin e TIK në shkolla. Objektivi i tij është që të kuptohen në mirë pikat e forta dhe dobësitë e përdorimit të TIK në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme. Kjo është bërë nëpërmjet tre lloj veprimesh, të cilat përshkruhen në vijim:

- Analizimit dhe shkëmbimit të eksperiencave të mira dhe identifikimit të praktikave të mira në vende të ndryshme që kanë zbatuar përdorimin e TIK në sistemin e tyre të arsimit.

- Studimit të mundësive për transferimin e praktikave të mira në

Koha e teknologjise se informimit dhe komunikimit ne shkolla

përdorimin pedagogjik të TIK tek të gjitha vendet europiane dhe mënyrave se si mund të ndodhë ky transferim.

- Fillimit të një debati të gjërë rreth mënyrës se si politika europiane rreth përdorimit të TIK në shkolla duhet që, nga një këndvështrim pedagogjik, të marrë në konsideratë efektet sociale dhe rreth politikave që duhen ndjekur në planet e ardhshme arsimore.

A u nevojitet TIK shkollave?

Shkollat në shumë vende përdorin TIK. Disa njerëz argumentojnë se shkollat mund të përdorin TIK në shkollat tona të gjera, ndërkohë që të tjerë argumentojnë se ka arsye për të qenë të kufizuar në lidhje me përdorimin e TIK në arsim. Një pikë fillimi e rëndësishme, në kuadrin e këtij projekti, mund të ishte një konsultim i gjërë për të arritur në një konkluzion sa më të përgjithshëm në lidhje me çështjen nëse shkollat aktualisht kanë nevojë për TIK apo jo.

Në vijim analizohen argumentet pro dhe kundër përdorimit të TIK në shkolla.

Shumë qeveri dëshirojnë të rrisin përdorimin e TIK në arsim.

Në kohët e sotme shumë qeveri janë të etura që të fusin TIK në arsim. Kjo tregohet, gjithashtu, në nivel europian. Në Konkluzionet Presidenciale të Këshillit Europian të Lisbonës, Këshilli bëri thirrje që "Shtetet anëtare të sigurojnë që të gjitha shkollat në Komitetin Europian të kenë mundësi përdorimi të Internetit dhe të burimeve multimediale deri në fund të vitit 2001, dhe që të gjithë mësuesit të jenë të kualifikuar në përdorimin e Internetit dhe burimeve multimediale deri në fund të vitit 2002"

Politikanët dhe të tjerë që marrin vendime në arsim ndonjëherë duket sikur janë shumë të vendosur në

besimin për përdorimin e TIK. TIK përshkruhet ndonjëherë si mjete për të zgjidhur të gjitha problemet. Siç edhe do të dalë në vijim, ka arsye për të qenë optimist për mënyrën e përdorimit të TIK në arsim, por është, gjithashtu, e nevojshme të kuptojnë që TIK nuk është thjesht një vegël. Optimizimi i pavlefshëm i kombinuar me lobing nga kompanitë e kompjuterave mund të çojnë drejt investimeve të tepëra në pajisjet e TIK në shkolla në kuriz të fushave të tjera njësoj të rëndësishme, siç janë trajnimet dhe zhvillimet profesionale në TIK. Problemi mund të jetë, gjithashtu, që këto investime u zenë vendin investimeve të tjera. Ndonjëherë, mund të ketë gjëra për të cilat shkollat kanë nevojë më shumë se kompjuterat dhe ka disa lloje të tjera investimesh bazë që duhen bërë para se shkollave t'u sigurohen kompjuterat.

Disa skepticizma tek mësuesit Ndërkohë që qeveritë janë shpesh të entuziaznuara për TIK, mund të vërehet që ky interes nuk përputhet gjithmonë me një entuziazëm të ngjashëm në rradhët e mësuesve. Të përdorësh TIK do të thotë që puna në shkollë duhet të organizohet në mënyra të reja dhe ndonjëherë mund të jetë e vështirë të gjenden metoda të reja pedagogjike që funksionojnë mirë së bashku me teknologjitë e reja. Mësuesit akuzohen ndonjëherë se janë konservatorë kur vjen puna për metodat e punës në klasë. Kjo është e diskutueshme, por me siguri që mund të argumentohet që mësuesit kanë përgjegjësinë të gjejnë metoda në mënyrën e tyre në të cilat besojnë dhe e dinë se do të funksionojnë. Nga kjo perspektivë, një masë e caktuar skepticizmi mund të jetë e shëndetshme.

Një arsye tjetër për të qenë skeptik lidhur me përdorimin e TIK në shkollë,

që është vënë në dukje nga mësuesit, është që nxënësit kanë nevojë të trajtohen në njohuritë tradicionale dhe aftësitë me numra. Nëse shkollat nuk e sigurojnë këtë trajnim, nxënësit nuk do ta marrin atë. Përdorimi i kompjuterëve, nga ana tjetër, është diçka që mësuesit mendojnë se nxënësit mund ta mësojnë në shtëpi.

TIK mund të përdoret për të përmirësuar aftësitë e nxënësve, por kjo kërkon që mësuesit të jenë trajnuar për të përdorur TIK në mënyrë të përfshirë në mënyrë që të përfshihet përdorimi i TIK në planifikimin e mësimit të tyre. Shumë mësues kanë frikë se përdorimi i TIK harxhon kohën e lëndës që kërkohet që ata të japin.

Komercializimi

Një nga rreziqet më serioze që lidhen me përdorimin e TIK në shkolla mund të jetë një komercializim në mjetet e arsimit. Ky zhvillim mund të shihet nga perspektiva të ndryshme. Është e qartë që ka shumë interes nga ana e kompanive që prodhojnë pajisje elektronike dhe programe për të shitur produktet e tyre. Është, gjithashtu, e qartë që me hyrjen e teknologjive të reja në arsim, një treg i ri po lulëzon. Nuk mund të përjashtohet që një arsye për interesin e treguar nga shumë qeveri për futjen e teknologjive të reja në arsim është e lidhur me lobingun e suksesshëm të kompanive të kompjuterëve.

Ka edhe një aspekt tjetër se si mund të përdoret TIK për të komercializuar arsimin. Teknologjitë e reja ofrojnë shumë mundësi për të organizuar arsimin në shumë mënyra. Arsimimi në distancë dhe universitetet që bazohen në këtë mënyrë komunikimi janë shembuj të saj. Këto mënyra të reja të arsimit nuk janë vetëm të lehta për t'u organizuar; pasi sigurohen

Koha e teknologjise se informimit dhe komunikimit ne shkolla

Vijn nga faqja 11

mjetet e nevojshme, ato janë, gjithashtu, të lehta për të kërkuar fitim. Ka që tani shumë shembuj të arsimit në distancë që mund të blihet në Internet. Shkollat private, institutet e arsimit në distancë dhe universitetet e hapura, si shtesa të arsimit të rregullt, kanë disa kohë që ekzistojnë. Një problem është, gjithashtu, mungesa e kontrollit cilësor në lidhje me shumë oferta arsimit në Internet.

Arsye të mjaftueshme për të përdorur TIK

Megjithatë, ka akoma arsye të mjaftueshme për shkollat për të filluar përdorimin e TIK. Një argument në favor të futjes së TIK në arsim është fakti që përdorimi i kompjuterave po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë integrale e jetës së përditshme. Shumë nga aplikimet praktike të njohura sot lidhen me përdorimin e TIK. Në të njëjtën mënyrë që shkollat kanë rolin që të sigurojnë nxënësit e studentët me njohuri për mjete të tjera që mund të përdoren për të komunikuar dhe për të marrë informacion, ato janë, gjithashtu, përgjegjëse për të ndihmuar mësuesit që të mësojnë të përdorin kompjuterin në mënyrë të përshtatshme, efikase dhe të përgjegjshme.

Ka edhe një argument tjetër të rëndësishëm për këtë. Megjithatë aksesit në kompjuter dhe internet është rritur vullshëm në vitet e fundit, në shumë vende ka akoma grupe të gjera familjesh që nuk kanë mundësi të kenë dhe të përdorin një kompjuter. Ka mundësi që ky grup të zvogëlohet gjithnjë e më shumë, por nuk mund të injorohet edhe fakti që në shumë shoqëri, ku pothuajse kushdo ka një kompjuter, do të vashdojë të ketë diferencime midis atyre që mund të kenë kompjuterat më modernë dhe atyre që do të përdorin akoma modele

që nuk janë në kohë me zhvillimet më të fundit në teknologji. Ashtu si të gjithë njerëzit nuk kanë modelet e fundit të makinave, po ashtu ata do të kenë edhe modele të ndryshme kompjuterash. Që sot, njëra e kompjuterit është një kusht paraprak për shumë punë dhe ata që nuk kanë pasur mundësinë të mësojnë të përdorin kompjuterat më modern dhe programet më të reja janë në disavantazh. Kjo mund të jetë edhe më e dukshme në të ardhmen.

Në këtë kontekst, shkolla mund të luajë një rol të rëndësishëm në lidhje me ndarjen digjitale në mënyrë shtëpive. Nëse shkollat sigurojnë akses në kompjuterat dhe programet më modernë, kjo do të krijojë mundësi më të mira për fëmijët e familjeve në disavantazh për të pasur të njëjtat aftësi dhe njohuri si ata të familjeve shumë të pasura.

Veç këtyre argumenteve, për përdorimin e TIK në shkolla mund të tregohet, gjithashtu, që TIK aktualisht ka potencialin për të përmirësuar arsimin. Kjo nuk do të thotë që përdorimi i TIK do të përmirësojë automatikisht cilësinë e arimit, por do të thotë që TIK është një instrument i fuqishëm me potencial të pamatshëm. Ky potencial është përdorur për të ndryshuar dhe, në shumë raste, edhe për të përmirësuar punën në shumë sektore të tjerë të shoqërisë.

Në sektorin e arsimit, edhe pa ndryshime radikale në metodat e mësimdhënies, TIK ofron shumë mundësi për të përmirësuar mësimdhënien në klasë: është më e lehtë për mësuesin të realizojë materialin që është programuar për nevojat e studentëve të veçantë; PowerPoint mund të përdoret për të përmirësuar leksionet tradicionale; programet e kompjuterit që pëmbajnë ushtrime praktike mund ta bëjnë atë që dikur ka qenë ushtrim me letër dhe laps

në tërheqës dhe kërkues.

TIK ka ndërlikime pedagogjike.

Një nga problemet kryesore që lidhen me diskutimin mbi TIK në arsim është që TIK ka deri tani shumë kontekste të diskutuara nga një perspektivë teknologjike. Është sigurisht e saktë të thuhet që TIK është një teknologji, por sfida për shkollat nuk është ta përdorin ose jo këtë teknologji, por mënyra se si duhet ta përdorin atë.

TIK nuk siguron vetëm një sërë mjedesh teknologjike. Ajo duhet të lidhet me synimet arsimore dhe objektivat. Shumë shpesh shkollat dhe autoritete të ndryshme arsimore janë përqendruar vetëm mbi teknologjinë, por jo në pyetjen se pse dhe si duhet të përdoret TIK? Shumë qeveri kanë krijuar programe të shtrenjta për të futur TIK, por kanë harruar të përqendrohen mbi mënyrën e përdorimit të TIK në klasë. Ka nevoja për të zhvilluar më tej pedagogjinë e TIK. Shkollat duhet të jenë të vetëdijshme që përdorimi i mirë pedagogjik i TIK duhet të jetë pjesë e një strategjie të tërë zhvillimi shkollor. TIK është vetëm një mjet pedagogjik, jo një synim në vetvete.

TIK ndryshon natyrën e punës së mësuesve, duke kërkuar aftësi dhe kompetenca të ndryshme, si lehtësim të punës së pavarur, rishikim kritik dhe analizë.

Mungesa e eksperiencës mbi përdorimin e TIK në mënyrë pedagogjike kushton kohë shtesë për përgatitjen e leksioneve ku përdoret TIK. Çështje e rëndësishme për mësuesit është identifikimi i asaj që do të dëshironin të bënin dhe si do të ndihmonte TIK për këtë. Në mënyrë që të bëhet kjo, është e rëndësishme të shihen edhe rreziqet edhe mundësitë që TIK mund të ofrojë.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

BRAKTISJA E SHKOLLËS FRENOHET ME BASHKËVEPRIM

Dikuri e dëmsme, që sjell analfabetizmin



Prof. as. Dr. MURAT GECAJ
Sekretar i Shoqatës së
Arsintarëve të Shqipërisë

Në një emision televiziv të para pak kohëve paraqitej jeta e vështirë e një familjeje fshatare në vendin tonë. Bashkëshortët kishin tre fëmijë të moshës shkollore. Por, për fat të keq, ata nuk e vijonin arsimin e detyrueshëm. Kur i pyeti telekronistja nëse dinin shkrim e këndim, ata mudhën supet të ndrojtur. Ndërsa prindërit e tyre u shfaqësuan duke thënë se nuk i kishin kushtet e nevojshme për t'i dërguar fëmijët në shkollë, pra u mungonin veshjet, ushqimi etj.

Por nuk janë vetëm këto shkaqet që e bëjnë të pranishme dukurinë e mosvazhdimtimit ose të braktisjes së shkollës nga fëmijët tanë. Kështu, jo rrallë nëpër rrugët e qyteteve, ku jetojnë, paradieteve shohim fëmijë që shesin cigare ose me kinkalerira ndër dar. Përpara nesh qëndrojnë edhe të tjerë fëmijë që lypin, që lustrojnë këpuçët e kalintarëve ose që pastrojnë makinat për njëzetë lekë pranë semaforëve. Fëmijë të vegjël të romëve u rrinë pranë nënave kur ato shesin rroba të vjetëruara a të përdurura. Kurse në fshat vihet re panje tjetër: Fëmijë të moshës shkollore ruajnë bagëtitë ose i ndihmojnë prindërit në punët bujqësore etj. Një kontingjent i veçantë i fëmijëve të moshës së arsimit të detyrueshëm, të cilët janë larguar nga shkolla në mënyrë të pavullnetshme, pra të detyruar nga rrethanat që nuk varen prej tyre, janë mjaft fëmijë të familjeve në

zonat veriore, të ngjuar për shkak të gjakmarrjes. Këtë gjë e kemi parë nëpër ekranet e TV-ve, kemi lexuar në gazeta e revista etj.

Tashmë është e njohur se një ndër detyrat kryesore të shkollës sonë është që të realizojë arsimin e detyrueshëm për çdo fëmijë të moshës 6-15 vjeç. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu IV, "Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale e kulturore", neni 57/1, përcjehet: "Kushdo ka të drejtën për arsim". Gjithashtu, po këtu thuhet se arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj dhe se arsimi në shkollat publike është falas. Kjo nënkupton që në vendin tonë arsimi 9-vjeçar është i detyrueshëm dhe të gjitha shpenzimet për të përballesh nga shteti, si lokalet e pajisjet shkollore, paga e mësuesve etj. Ndërsa në nenin 36(1) të "Dispozitave Normative për Arsimin Parauniversitar" theksohet se fëmija parashkollor dhe nxënësi kanë të drejtë

dhe, më vonë, të vazhdojnë sipas dëshirës shkollat e mesme e të larta. Por, ashtu siç jani dëshmitarë të gjithë dhe siç flasin statistikët zyrtarë, në praktikën e përditshme vërehet se jo të gjithë fëmijët e kësaj moshe e ndjekin rregullisht shkollën, madje disa prej tyre e kanë braktisur atë. Në këtë mënyrë ka lindur një dikuri e padëshinuar, është formuar një plagë shoqërore, e cila njihet me emrin "analfabetizëm". Prandaj ministri i Arsimit dhe Shkencës, z. Genc Pollo, në përsëritjet e tij me rastin e vitit të ri shkollor 2005-2006, para prindërve, gjithë punonjësve të arsimit, organeve të pushtetit dhe mbare shoqërisë shtroi detyrën e rëndësishme: "Të mundësohet që çdo fëmijë të ulët një ditë në bankat e shkollës dhe të qëndrojë aty nëntë vjet". Pra, na kërkohet që përpjekjet e të gjithëve të bashkohen në një qëllim të madh: të mos lejojnë braktisjen e fëmijëve nga shkolla dhe mos ta mbajnë të hapur plagën e



të edukohen dhe të mësohen në kopësht dhe në shkollë në kushte normale, të sigurta dhe të përshtatshme.

Pra, te ne synohet dhe bëhen përpjekje të gjithanshme që fëmijëve të moshës së arsimit të detyrueshëm 9-vjeçar t'u sigurohen të gjitha mundësitë ligjore që të ndjekin rregullisht mësimet, ta përfundojnë normalisht këtë cikël

analfabetizmit.

Siç është e kuptueshme, çdo plagë duhet të mjekohet mirë e me kujdes, pra të çrënjohet, përdryshe ajo lëshon "metastaza" dhe përsëritet. Me gjithë taburë që ekzistonte në vitet e shtetit monist që mos të flitej asgjë për

BRAKTISJA E SHKOLLËS FRENOHET ME BASHKËVEPRIM Dukuri e dëmshme, që sjell analfabetizmin

Vijon nga faqja 13

braktisjen e shkollës dhe ringjalljen e analfabetizmit, të dhënat zyrtare dëshmojnë se, që në vitin arsimor 1983-1984, kishte braktisje të shkollës nga nxënësit në masën 1,42 për qind. Shënjat e ringjalljes së analfabetizmit u dukën dhe në vitet pasardhëse dhe, me fillimin e viteve të tranzicionit, tek ne u gjjet mjedisi i përshtatshëm për rishfaqjen e kësaj dukurie negative. Në të vërtetë, shifrat zyrtare dëshmojnë për luhatje të treguesve të tyre dhe ato mund të merren me një farë rezerve. E themi këtë gjë pasi, në debatet e ndryshme televizive dhe në shtypin e shkruar, duke e politizuar dukurinë, shpesh janë përmendur shifra, që nuk përputhen me njëra-tjetrën. Përqindjen në të lartë të braktisjes së arsimit të detyruar nga nxënësit e kanë pasur rrethet Kukës, Dibër, Kavajë, Peqin, Tiranë (rreth) etj. Numri i largimeve të nxënësve nga shkolla është vërejtur kryesisht në ciklin e ulët. Sigurisht, ndër të tjera, për këtë gjë ka ndikuar për kaq dhe lëvizja e pakontrolluar e popullsisë nga zonat malore e fshatare drejt qyteteve, ku kanë munguar kushtet normale për vazhdimin e shkollave nga nxënësit dhe kryerjen e arsimit bazë.

Po të ndalem në shifrat e publikuara pak kohë më parë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke i marrë ato të mirëqena, del se në vitin arsimor 1990-1991 braktisja e shkollës ishte në masën 3,9 për qind dhe një vit më vonë arriti në 6,31 për qind e në tej ra në 4,09 për qind. Në vitet pasardhës, deri në vitin arsimor 1999-2000 këto shifra përsëri u luhatën nga 2,8 për qind, në 1,8 për qind e 1,6 për qind. Por, po të kemi parasysh se në vitin 2002-2003, për shërbull, kishte 1.838 shkolla 8-vjeçare, që i vijonin 515.782 nxënës, përqindja e braktisjes së tyre 1,8 për qind tregon se vetëm atë vit janë larguar nga arsimi i detyruar një sasi e konsiderueshme nxënësish. Po kështu mund të thonim dhe për vitet e tjerë shkollorë.

Por një gjë është e sigurtë, që dukuria e analfabetizmit bashkëjeton me ne, pra është e pranishme dhe në vitin shkollor 2005-2006. Për këtë arsye, është e nevojshme që problemi të vlerësohet seriozisht dhe larg politizimeve, pasi pasojat i vuan nbarë shoqëria jonë. Askush nuk duhet ta minimizojë këtë dukuri negative dhe prandaj kundër saj lipsen masa të shpejta, efektive e të shumanshme.

Pra, kërkohet të veprojmë të gjithë së bashku, me synimin që fëmijët tanë ta ndjekin rregullisht shkollën dhe aty të rikthejnë çdo nxënës, i cili është larguar prej saj për arsye të ndryshme.

Para së gjithash, në këtë drejtim mund e lipset të bëjë ende më shumë familja, qeliza bazë e shoqërisë. Braktisjet e fëmijës nga mësimi vijnë edhe nga që prindërit nuk e mbajnë afër atë, pra nuk e këshillojnë e nuk e ndihmojnë sa duhet, nuk ia sigurojnë kushtet minimale ose nuk vendosin bashkëpunim të rregullt me mësuesit e me shkollën etj. Por në jetën e përditëshme shohim se më e vështirë bëhet kjo gjë, sidomos kur prindërit kanë mosmarrëveshje me njëri-tjetrin ose kur ata ndahen ligjërisht. Po kështu, burim largimesh nga shkolla janë dhe fëmijët e emigrantëve. E themi këtë gjë pasi jo rrallë vërehen raste që, sidomos babai, shkon jashtë shtetit për arsye ekonomike dhe qëndron atje për një kohë të gjatë, duke e lënë fëmijën pa kujdesin e nevojshëm prindëror.

Por shtrohet dhe një pyetje e natyrshme: Shkolla jonë çfarë bën para kësaj dukurie, e cila vështirë se po na shpëton? Është e vërtetë se tek ne janë miratuar sanksione ligjore ndaj atyre prindërve, fëmijët e të cilëve braktisin mësimin. Ndërsa në praktikë vërehet se masat shtërnguese ose ndëshkuese pothuajse nuk zbatohen nga personat e ngarkuar të pushtetit vendor etj. Ndikim pozitiv në këtë drejtim do të ketë, sigurisht, dhe presioni që ushtrohet për frenimin e kësaj dukurie negative. Dihet se parësore nuk janë gjdoat, por është

dhe duhet të jetë puna e përditëshme e mësuesit dhe e shkollës, në përgjithësi. Se, jo rrallë, ka mësues e drejtues që tregohen indiferentë ndaj rasteve të largimit të nxënësit nga mësimi, që pastaj, nga disa pakujdesi, kthehet në braktisje të shkollës prej tij.

Mendojmë se një burim i mirë frymëzimi për kapërximin e kësaj pengese në ecjen tonë përpara drejt një shoqërie të zhvilluar është njohja, popullarizimi dhe përgjithësimi i shërbujve pozitivë, të cilët janë të shuntë në mjediset tona, në drejtim të tërheqjes së fëmijëve në shkollë dhe ruajtjes së kontingjentit të tyre. Për shërbull, në disa shkolla 9-vjeçare të qytetit të Tiranës kemi vërejtur se braktisja e shkollës është në shifrën "zero". Por raste të tilla ka shumë dhe në rrethet e tjerë të vendit. Sigurisht, kjo është meritë e punës së bërë nga drejtoritë e kolektivat pedagogjikë, por dhe nga organizmat të ndryshme shoqërore, si sindikatat e arsimit, shoqatat e mësuesve etj. Por në këtë drejtim mund e lipset të punchet më mirë, pra të bashkëveprojmë të gjithë drejt një qëllimi për të mos lejuar që ndonjë fëmijë ta braktisë shkollën dhe kështu të ngelet analfabet.

Por po kaq rëndësi ka që edhe ta shërojmë këtë plagë kaq të dëmshme për shoqërinë tonë, atje ku ajo është shfaqur. Për këtë qëllim organet e arsimit dhe ato të qeverisjes vendore, në bashkëpunim me organizmat shoqërore, kërkohet të evidentojnë çdo rast dhe, në përshatje me mundësitë e merrnat, të arrijnë që të gjithë fëmijët e moshës së përcaktuar me ligj ta ndjekin normalisht shkollën. Duke kërkuar ndihmën e fondacioneve dhe të shoqatave humanitare, të biznesmenëve ose të bamirësve të ndryshëm, do të zgjidheshin dhe qëllim me karakter familjar, ekonomik etj. Kështu jemi të sigurtë se do t'i sillnim një shërbim të pallogaritshëm të sotmes dhe të ardhmes së shoqërisë e të vendit tonë.

Të reja shkencore

SIPAS FORMËS



Një derë që përshtatet si një dorashkë? Ajo është Dera Automatike e Fadukas, e projektuar në Japoni. Ajo hapet aq sa është e nevojshme për t'iu përshtatur formës së një njeriu ose objekti që kalon përmes saj. Porta elegante që arrin të kapë lëvizjet kursen energji duke mos lejuar që dera të hapet plotësisht. Kjo ndihmon për të mbajtur një temperaturë stabile të dhomë dhe mund të parandalojë papastërtitë dhe materialet e tjera që të mund të futen brenda. Përveç njerëzve, sistemi i ri mund të përdoret për sende të vogla, si pakot e sjella me postë ose për gjëra më të mëdha, si një makinë që hyn në garazh. Kjo shpikje është akoma vetëm një prototip.

NË PËRSHTATSHMËRI ME SPORTIN

Lentet e kontaktit MaxSight, të lyera me një substancë të verdhë në kafe, nga Nike, pakësojnë dritën blu në mënyrë që të ulët shkëlqimi dhe të përmirësohet dukshmëria e topave të bejzbollit, tenisit dhe objekte të tjera të lëvizshme. Një version gri-jeshil u jep lojtarëve të golfit avantazh, duke rritur të tatëpjetat



dhe kthesat e pjesës së fundit të terrenit të golfit. Sportisti kryesor i një skuadre profesionale ia atribuon lenteve MaxSight suksesin

e tij këtë sezon. Lentet, si edhe ato që pëdoren në syzet e mira, ulin rrezet ultraviole.

NJËRIU QË ECËN

Hyr gjyshe Mecha! Shkencëtarët japonezë kanë krijuar një skelet roboti për të ndihmuar të moshuarit dhe të paaftët të ecin dhe madje edhe të ngrenë objekte të rënda si bidonin e ujit që tregohet më poshtë. Quhet Hibrid Assistive Limp ose HAL. Truri i tij është një kompjuter (i vendosur në një çantë pas shpine) që mëson të imitojë ecjen dhe qëndrimin e atij që e mban. Sensorë bioelektrik kapin sinjalet e transmetuara nga truri drejt muskujve dhe, kështu, ai mund të përshejtojë lëvizjen që personi që e mban mendon të bëjë. Për momentin



po punohet me një version komercial që kushton 14 000-19 000 USD.

TELEVIZORI JUAJ KUDO

Kohë pas kohe, ndodh të shpiket një pajisje që ndryshon zakonet tona në lidhje me televizorin. Tani vjen një e re që nuk ndryshon kohën kur të shohësh



televizor, por vendin. Slingbox lidhet me televizorin tuaj të shtëpisë dhe transmeton çfarëdo që të ketë në ekran te çfarëdo pajisje e lidhur me rrjetin dhe ku janë instaluar programe të veçanta. Po pret avionin në Paris? Përdor laptopin tënd dhe rrjetin e internetit të aeroportit për të parë lajmet lokale në vendin tënd, një DVD ose një shfaqje të vjetër të ruajtur në kasetë. Mund edhe të ndryshosh kanalet. Veçoria më e mirë është se nuk ka nevojë për tarifa regjistrimi. Ju mund ta bëni tuajën Slingbox vetëm për 250 USD.

Keshilla praktike

KATËR KËSHILLA PËR TË BËRË TË MIRË PËR JU NJË PUNË TË KEQE

Nëse jeni si shumica e profesionistëve, juve ju është dashur të kaloni disa prova dhe gabime për të arritur një punë të përshtatshme për ju. Shumica nga ne kanë pasur të paktën një punë vërtet të keqe në jetën tonë dhe shumë mund të jenë akoma duke u ankuar për një situatë të keqe pune në këtë moment. Por, profesionistët e suksesshëm mësojnë si t'i kthejnë situatat e këqija në mundësi. Këshillat e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë të shtrydhni limonët e karrierës që ju kanë ardhur në dorë.

1. Mendoni përtej dhomës së suaj

Shpesh një njëri me një punë të keqe nuk është i kënaqur me pozicionin dhe ndonjëherë edhe me kompaninë. Nëse problemet e punës burojnë nga konfliktet personaliteti ose çështje të veçuara nga pozicioni juaj, mos e hidhni edhe fëmijën bashk me ujin me të cilin e keni larë atë. Në vend që thjesht të heqësh dorë, këshillohet të gjesh pozicionin tënd të përshtatshëm, sugjerohet të përdorësh kohën që kalon në kompani për të kontaktuar me drejtorët ose për të gjetur një këshillatari dhe për të mësuar për departamentet e tjera me qëllimin për t'u transferuar në një pozicion më të mirë.

2. Merrni atë që ju nevojitet

Çdo punë, nuk ka rëndësi se çfarë është, ju jep diçka shumë të rëndësishme: eksperiencën. Mos u nxitoni duke e cilësuar punën si një situatë që nuk ka asgjë për t'ju ofruar. Përdorni si një gur themeli, megjithëse është një punë e keqe. Marifeti është ta shikoni këtë eksperiencë në mënyrën e duhur. Ju duhet të shikoni se çfarë aftësish po përfitonit ose çfarë ka rrotull jush për të pasuruar punën tuaj. Për shembull, ju ndoshta thjesht përgjigjeni në telefon dhe çoni porosi gjithë ditën, por kjo do të thotë se po fitoni aftësi të vlefshme komunikimi dhe organizimi. Ju do të jeni në gjendje të pasuroni kurikulin tuaj dhe të jeni më të vlefshëm për një punëdhënës potencial.

3. Mbani shënim ato që nuk ju pëlqejnë

Një nga gjërat më të mira që mund të dini kur po kërkoni një punë është ajo që nuk doni. Po, ju mund të jeni duke punuar për një drejtor shumë të pakëndshëm, por lufta do t'ju mësojë se çfarë duhet të mbani larg herën tjetër. Nëse jeni të punësuar në një kompani me praktika të diskutueshme, ju do të mësoni si ta zgjidhni më mirë punëdhënësin tuaj herën tjetër. Ose, ju mund të mësoni, gjithashtu, se cilat përkrahje pune të shmangni.

4. Përfitonit nga mundësitë që ju paraqiten në vendin e punës

Shumë kompani ofrojnë kurse trajnimi, seminare dhe mundësi të tjera zhvillimi për nëpunësit e tyre. Përfitonit nga këta përforcues të karrierës. Ju duhet të përpiqeni të merrni aftësi shtesë për të përmirësuar punën në të cilën jeni dhe punën që shpresoni të keni. Regjistrohuni në seksionet dhe kurset e trajnimit të sponsorizuara nga kompania dhe jini më të përgjegjshëm në marrjen e aftësive të reja. Përpiqeni të shtriheni në gjërat që doni të bëni dhe pëlqeni të bëni. Çelësi është të mos uleni dhe të prisni që t'ju gjejnë mundësitë por të shkoni të merrni atë që dëshironi. Ju mund të zgjidhni të shkoni në punë çdo ditë dhe të prisni për një mundësi më të mirë, ose mund të mësoni shumë nga eksperiencia.

Përgatiti faqen Erica Vangjeli

Tribuna sindikale

